

VENDIM
Nr. 663, datë 13.10.2022

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE ‘QAZIM TURDIU’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare ‘Qazim Turdiu’”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.
 3. Pronarët e pasurisë, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 10 833 624 (dhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 10 833 624 (dhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Bashkisë Tiranë.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Tiranë.
 8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, nisin procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrojnë aktin e kalimit të pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Tiranë.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Tiranë.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILËVE
PREKEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE ‘QAZIM TURDIU’”

Nr.	PRONARI			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji pas.	Sipërfaqe e shpronësuar	Çmimi lekë/m2	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Hajredin Boka Jemine Boka Menduhie Boka Merita Boka Naile Boka Saimir Boka Sinan Boka Skender Boka			8330	9/216	1755	Truall	318	34,068	10,833,624	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera										10,833,624	

Për tokën "truall", çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Kështillit të Ministrave, "Për miratimin e bartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".